



**Hapet Thirrja për mobilitete stafi të UPT-së  
në kuadër të Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus +  
në University of West Attica, Greqi**

Në kuadër të marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për mobilitete për stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, University of West Attica, Greqi.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:** Shkëmbimin e stafit akademik për pjesëmarrje në javën ndërkombëtare Erasmus+, (4<sup>th</sup> E+/ICM International Week).

**Fusha e pjesëmarrësve:** Të gjitha degët.

**Numri total i stafit: 1**

**Koha e kryerjes së mobilitetit: 5 ditë + 2 ditë udhëtim, (18 – 22 nëntor 2024).**

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin akademik:**

- CV + lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës\*;
- Dokumenti i Mobility Agreement (Staff Mobility for Teaching) për stafin akademik, në universitetin pritës\*\*.

*\*Plani i mobilitetit dhe periudha e propozuar e mobilitetit duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore ku aplikanti bën pjesë.*

*\*\* Mobility Agreement for Teaching për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

Për të shkarkuar formatin Staff Mobility for Teaching, ju lutemi klikoni te: [Aneks 4](#).

**Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: 19 tetor 2024, ora 12.00.**

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT, si dhe **për aspektin financiar të mobilitetit**, ju lutemi kontaktoni në email: [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al), [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al)